

NSPCC



A jeni ju fëmijë i cili ka ardhur në Mbreterinë e Bashkuar nga një shtet tjetër?

**Kuptoni për të drejtat e fëmijëve në Mbreterinë e
Bashkuar dhe kush mundet t'ju ndihmoj.**



**Albanian
Shqiptar**

EVERY CHILDHOOD IS WORTH FIGHTING FOR

Përshëndetje

Nëse ju jeni fëmijë që keni ardhur në Mbretërinë e Bashkuar nga një shtet tjetër, atëhere kjo fletushkë mund të ju ndihmojë.

Është shpjegon fjalët si ‘refugjat’, ‘azil kërkues’ dhe ‘trafikim’. Dhe mund të lexoni për njerëzit e ndryshëm që mund të takoni në vendet që mund të shkoni.

Po ashtu do të gjeni numra të telefonit që janë të dobishëm, adresa interneti dhe adresa emaili. Nëse dëshironi të flisni me dikë menjëhere, ju mund të telefononi NSPCC në numrin **0808 800 5000** ose me e-mail **help@nspcc.org.uk**

A jam unë legalisht fëmijë?

Fëmijë në Mbretërinë e Bashkuar është çdo kush që është nën moshën 18 vjeçare. Mbi këtë moshë, ju do të konsideroheni si i rritur dhe do të keni të drejta tjera nga.

Disa persona të rinj janë në ‘moshë të debatueshme’ që do të thotë se mosha e tyre është në pikë pyetje. Ata duhet të trajtohen si fëmijë deri sa të bëhet një vlerësim i moshës.



Si t'i kuptoni të gjithë emrat e ndryshëm

Ka emra të ndryshëm për fëmijët që vijnë në Mbretërinë e Bashkuar. A mund të përgjigjeni me po në ndonjërin prej pyetjeve të më poshtme?

Fëmijë i trafikuar

A ju ka sjellë dikush në Mbretërinë e Bashkuar dhe ju detyron të punoni orë të gjata pa pagesë?

Kur mbërritët në këtë shtet, a ju detyruan të keni marrëdhënie seksuale më dikë?

Mos ju ka detyruar ndokush që të vidhni, të kujdeseni për kanabis, të mbani apo të shitni drogë?

A ju kanë detyruar të jetoni me ndonjë familje të cilët nuk i keni njohur apo ju kanë detyruar të bëni punë shtëpiake, apo të kujdeseni për fëmijë?

A ju kanë detyruar të martoheni me njëzë të panjohur?

Refugjat

Jeni larguar nga vendi juaj sepse nuk ishit të sigurtë?

A ju kanë dhënë dokumenta legale ku thuhet që ju jeni refugjat dhe tani mund të jetoni dhe të punoni në Mbretërinë e Bashkuar?

Kërkues azili, i pa shoqëruar

Keni ikur i vetëm nga shteti juaj që ti shpetoni keqtrajtimeve dhe kërcënimeve?

A nuk jeni me prindërit apo kujdestarin?

Keni shkuar në zyrën e imigracionit të aplikoni për qëndrim si azil kërkues në Mbretërinë e Bashkuar?

Fëmijë shtetas i huaj

Keni lindur jashtë Mbretërisë së Bashkuar dhe nuk keni pasaportë Britanike?

A jeni qytetar i ndonjë shteti që është pjesë e Bashkimit Evropian? Nëse jeni qytetar i Bashkimit Evropian atëherë ju keni të drejtën e lëvizjes së lirë brenda Bashkimit Evropian.



Çfarë është trafikimi?

Trafikimi (që ndonjherë quhet ‘skllavëri moderne’) është kur fëmijët (nën moshën 18 vjecare) barten prej një vendi në vendin tjetër apo prej një shteti në shtetin tjetër. Fëmijët barten që të shfrytëzohen apo të përdoren në ndonjë mënyrë.

Ka njerëz që mund ta ndalojnë këtë.

Kush është ‘trafikuesi’?

Trafikuesi është ai person i cili është i përfshirë në bartjen e fëmijëve nga një vend në vendin tjetër. Kjo bëhet që t’ju shfrytëzojnë apo t’ju keq-trajtojnë në ndonjë mënyrë.

Si ndodh kjo?

Ju apo familja juaj ndoshta keni takuar dikë të cilët kanë bërë premtime të cilat nuk mund ti mbajnë, si psh jetë me të mirë, shkollim, punë ose para.


Në disa raste, dikush mund t’ju kërcenohet juve ose familjes nëse nuk beni çfarë kërkojnë nga ju. Ose ndoshta pretendojnë se ju i keni borxh sepse ju kanë sjellë në Mbretërinë e Bashkuar.

Ju mund të shiteni apo të trafikoheni nga ndonjë anëtar i familjes apo dikush tjetër që e njifni.

Çfarë ndihme keni në dispozicion?

Në Mbretërinë e Bashkuar, me ligj kërkohet që fëmijët të mbrohen që ata të jenë mirë dhe të sigurtë.

Në faqet që vijojnë, ju mund të lexoni për të gjithë njerzit e ndryshëm që mund t’ju ndihmojnë.



Njerëzit dhe vendet

Ndoshta duhët të takoni shumë njerëz të ndryshëm apo të shkoni në vende të ndryshme që të siguroni ndihmën që ju nevojitet. A jeni në dijeni për njerëzit dhe vendet sic vijojnë më poshtë?



Policia (Police)

Nëse ju ka lënduar dikush, policia mund t'ju ndihmojë. Mund të telefononi në numrin 999.

Policia e ka për detyrë të hetojë krimet dhe të mbrojë publikun.



Punonjësi social (Social worker)

Është detyrë e punonjësit social që t'ju mbajë të sigurtë. Ata kanë mundësi të gjejnë vend të sigurt për juve që të qendroni, t'ju dërgojnë tek mjeku e po ashtu edhe që të regjistroheni në shkollë apo kolegji.

Nëse duhet të qendroni në Mbretërinë e Bashkuar, punonjësi social i juaj duhet të gjejë avokatit për ju. **Ju nuk duhet të paguani** punonjësin social.



Avokati (Solicitor)

Ky është dikush që mundet t'ju ndihmojë me çështje ligjore. Ju mund të takoheni me avokatit të ndryshëm.

Avokati i komunitetit mund të ju ndihmojë nëse dikush nuk ju beson që ju jeni fëmijë, apo nëse nuk po e merrni ndihmën që ju kërkoni.

Avokati për çështje migracioni ju ndihmon që ju të aplikoni për qendrim në Mbretërinë e Bashkuar.

Avokati për çështje kriminale ju përfaqëson nëse keni probleme me ligjin.



Kujdestari i juaj / stafi i shtëpisë (Foster carer/residential staff)

Kujdestari juaj apo stafi i shtëpisë e ka për detyrë të kujdeset për juve. Ata kujdesen për juve duke u siguruar që ju ti keni gjërat që ju nevojiten sikurse, strehë, ushqim dhe rroba.

Ju mund të praktikoni religjionin e juaj në këtë shtëpi edhe nëse religjioni i njerzve që jetojnë me juve është tjetër nga ai i juaji.



Gjykatesi (Judge)

Gjykatesi për çështje migracioni është një person i cili vendos për juve nëse keni drejtë të jetoni dhe të punoni në Mbretërinë e Bashkuar.

Ju mund ti takoni këta nëse aplikacioni për leje qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar refuzohet dhe nëse duhet të shkoni për apelim kundër vendimit. Ju mund të takoni edhe gjykatësin i cili merret me çështje kriminale nëse keni bërë ndonjë krim. Në raste të tilla avokati është me juve që t'ju ndihmojë.

Interpretesi/Përkthyesi (Interpreter/translator)

Ky është personi i cili i përkthen fjalet në gjuhën tuaj. Nuk është problem nëse kërkoni nga përkthyesi të përsërisë çka tha nëse nuk e keni kuptuar.



Shërbimet shëndetësore (Health services)

Nëse keni nevojë për shërbime shëndetësore, ju mund të shkoni në spital apo në klinika (walk-in centre) që të takoheni me mjekun ose infermierin.

Ju nuk duhet të paguani.



Zyra e vendit (Home Office)

Zyra e vendit është department qeveritar për migracion, pasaporta dhe gjëra tjera. Ju do të takoheni me zyrtar të zyrës së vendit nëse ju vini nga ndonjë vend që nuk i takon Bashkimit Evropian.

Zyra e vendit merr vendim nëse ju lejoheni apo jo të qendroni në Mbretërinë e Bashkuar.

Organizatata jo-qeveritare (NGOs)

Këto janë organizata që ju ndihmojnë njerzve. Janë si bamiresi. Ka shumë organizata jo-qeveritare të cilat ndihmojnë fëmijët që vijnë nga shtete të tjera, si p.sh The Refugee Council (Këshilli i refugjatëve).

Vlerësimi

Punonjesit social duhet të vleresojnë sigurinë tuaj, nevojat e juaja dhe të planifikojnë për jetën tuaj. Ata ndonjëherë punojnë së bashku me policinë kur ndonjë fëmijë është lënduar e po ashtu hetojnë kur fëmija është abuzuar, shfrytëzuar apo trafikuar.

Mekanizmi kombëtar i referimit (NRM) mundëson referimin e njerëzve, viktimat të trafikimit. Pyetni punonjës tuaj social apo policinë për më shumë informata.

'Vlerësimi i moshës' është mënyra që të kuptohet sa vjeçar jeni.

Juve mund t'ju bëhet vlerësimi i moshës nëse njerëzit kanë dyshime për moshën tuaj.

Dy punonjës social e bëjnë këtë vlerësim të moshës. Ju mund të keni

të pranishëm persona të tjere nëse dëshironi, sikurse punonjës in ndihmës. Është e drejtë e juaja të keni dike me vete.

Vlerësimi i moshës kërkon kohë të gjatë dhe juve ju mundësohet që të keni pushim. Juve po ashtu duhet t'ju lejohet të përgjigjeni çfardo që nuk është e qartë për punonjesit social për atë çka thoni.

Mbasi që përfundon vlerësimi i moshës atëhere juve ju tregohet vendimi dhe çfarë do të thotë për juve. Nëse ju nuk pajtoheni me vendimin atëhere avokati ka mundësi t'ju ndihmojë që ta sfidoni vendimin.

Vendimi ju jepet me shkrim dhe shpjegohet se çfarë do të thotë kjo për juve. **Ju lutem të bëni këtë brenda tre muajve pas kryerjes së vlerësimit.**

A keni nevojë për ndihmë?

Ka shumë organizata të cilat mund t'ju ndihmojnë. Këtu keni disa numra telefoni, faqe të internetit dhe adresa emaili.

Policia (Police)

Telefoni 999 (Emergjence)
ose 101 (jo-emergjence)
www.police.uk

Nëse doni të ankoheni kundër policisë ju lutem vizitoni
www.ipcc.gov.uk/complaints

NSPCC linja për ndihmë (NSPCC helpline)

0808 800 5000
www.nspcc.org.uk
help@nspcc.org.uk

Këshilli për refugjatët (Refugee Council)

0207 346 1134 (Kërkoni të bisedoni me seksionin e fëmijevë)
www.refugeecouncil.org.uk
children@refugeecouncil.org.uk

Linja për ndihmë të skllaverisë moderne (Modern Slavery Helpline)

0800 0121 700
www.modernslavery.co.uk

Zyra këshilluese për qytetarë (Citizens Advice Bureau)


03444 111 444 (Angli)
03444 77 20 20 (Vells)
www.citizensadvice.org.uk

Linja për fëmijë (Childline)

0800 1111
www.childline.org.uk

Tre ide për të kërkuar këshillë


1. Kurrë mos kini frikë të kërkonit këshillë apo të pyetni për gjëra të cilat nuk i keni kuptuar.
2. Kur të telefononi për këshilla, gjithmonë pyetni për emrin e personit, departamentin dhe rolin e tyre. Ndoshta ju nevoiten këto informata nëse duhet të telefononi sërish.
3. Mbajeni në mend se ju keni të drejtë të kërkonit ndihmë dhe të merrni informatat që ju nevojiten.



Kush është NSPCC?

Neve ju ndihmojmë fëmijëve të rindertojnë jeten e tyre, mbrojmë ata që janë të rrezikuar, gjejmë menyra si të parandalojmë ndodhjet e abuzimeve. Pra, kur fëmijet kanë nevojë, neve jemi aty.

www.nspcc.org.uk





Kontaktet e mia



Punonjësi im social është

numri i telefonit të tyre është



Kujdestari im është

numri i telefonit të tyre është



Avokati im është

numri i telefonit të tyre është



Ndihmës punëtori im është

numri i telefonit të tyre është